



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

NJOFTIM

BAZA LIGJORE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin “Për mbrojtjen Civile”, si dhe VKM nr.750 datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranë”i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.641 datë 07.12.2019 si dhe VKB-në nr.643 datë 10.12.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.641 datë 07.12.2019 për miratimin e listës paraprake të familjeve të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019 të cilat do të përfitojnë nga subvencionimi i qirasë”.

PROGRAMI I BONUSIT TË QERASË

Përshkrimi sipas vkb nr.641 datë 7.12.2019 dhe vkb nr.643 datë 10.12.2019	Dokumentat plotësohen nga:
1. Kërkesë për përfitimin e bonusit të qerasë	Qytetari
2. Vërtetim nga njësia administrative/lagja se banesa rezulton e pabanueshme	Qytetari
3. ID e qytetarit	Qytetari
4. Kontratë qeraje	Qytetari
5. Llogarinë bankare (Iban) të personit aplikues për bonus qeraje	Qytetari
6. Çertifikatë familjare	Bashkia
7. Akt konstatimi	Bashkia

Shënim: pika 1 - kërkesa bëhet pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të Bashkisë Durrës. Pika 4 - Bashkia Durrës ka formuluar kontratën tip të qerasë për t’u tërhequr pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, Bashkia Durrës, **kontratë e cila është orientuese për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe jo detyruese**, pasi kontrata e qerasë mund të nënshkruhet dhe pranë noterit ose midis palëve personalisht.

Për personat të cilët kanë aplikuar për bonus qeraje dhe nuk kanë plotësuar të gjithë dosjen duhet të paraqiten në sportelin e Bashkisë Durrës për plotësim dokumentacioni.